



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

Nr. 154/
18 Prot.

Tiranë, më 18. 11 .2019
(Lutemi referojuni në rast përgjigje)

LËNDA: Njoftim për vend të lirë pune

DREJTUAR: AGJENCISË SE PROKURIMIT PUBLIK

TIRANË

Në zbatim të Vendimit Nr. 109, datë 15.02.2017 të Këshillit të Ministrave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në Arsimin e Lartë”, i ndryshuar, Urdhërin e Kryeministrit Nr. 171 datë 27.09.2010 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë së Akreditimit të Arsimit të Lartë”, dhe VKM Nr.143 datë 12.03.2014 “Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të levizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civil të kategorisë ekzekutive, të ulët e të mësme drejtuese”, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), shpall njoftimin për **1 (një) vend të lirë pune në pozicionin e Specialistit pranë Sektorit të Shërbimeve dhe Publikimeve.**

Të interesuarit duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

I. Kërkesa të përgjithshme për kandidatin:

1. Të ketë përfunduar arsimin e lartë dhe të zotërojë një diplomë universitare të paktën Master Shkencor ose ekuivalent me të, me formim në një nga fushat: shkenca shoqërore ose shkenca humane;
2. Preferohen kandidatë të cilët kanë përvojë pune në profesion që ka lidhje me pozicionin e shpallur, si dhe kandidatët që kanë përvojë pune në arsimin e lartë ose që kanë lidhje me arsimin e lartë;
3. Të zotërojë gjuhën angleze, të çertifikuar në një nga testet ndërkombëtare të njohura nga MASR, me dëshmi në nivel mbi mesataren;
4. Të ketë njohuri të mira kompjuterike në programet bazë.

II. Kërkesa të veçanta për kandidatin:

1. Të ketë njohuri të mira ligjore sidomos përsa i përket legjislacionit të arsimit të lartë dhe akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe të programeve të tyre të studimit;

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr. 219, Tiranë; Tel: +355(0)2243423/2266203;
web: www.ascal.al; e-mail: info@ascal.al

2. Të ketë njohuri të mira kompjuterike në programet bazë dhe të avancuara për administrimin dhe përpunimin e dokumentacioneve;
3. Të ketë eksperiencë të mëparshme profesionale;
4. Të ketë dhe të dëshmojë aftësi të mira shkrimi dhe komunikimi;
5. Të dëshmojë aftësi për të punuar në grup.

III. Dosja e aplikuesit duhet të përmbajë:

1. Jetëshkrimin (*Curriculum vitae*);
2. Kërkesën me shkrim dhe kontaktin personal;
3. Diplomën dhe listën e notave të noterizuar;
4. Dëshmi të kualifikimeve pasuniversitare të kryera apo në proces;
5. Fotokopjen e librezës së punës, të noterizuar;
6. Dëshminë e gjuhës angleze/huaj, të noterizuar;
7. Fotokopje të dëshmive të kualifikimeve të kryera, të noterizuara;
8. Vlerësime pune nga punëdhënësi/t e mëparshëm;
9. Vërtetimin e Gjendjes Gjyqësore.

Vlerësimi i kandidatëve do të bëhet me sistem pikëzimi, mbi bazën e dokumentacionit dhe përmes një interviste në prani të një komisioni të ngritur posaçërisht për këtë qëllim.

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë ASCAL dosjen me dokumentacionin e kërkuar deri më datën **02.12.2019, ora 12:00** në adresën e mëposhtme:

**Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë.
Rruga e Durrësit, pranë Gjimnazit “Qemal Stafa”
Tel: 4 22 43 423**

Mund të aplikojnë për këtë pozicion edhe punonjës të ASCAL. Për këta kandidatë kërkohet plotësimi i dokumentacionit sipas pikës III ose përditësimi i atij ekzistues.

Njoftimi të bëhet edhe në web site e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë:

www.ascal.al.

DREJTORI

Elvin Gjevori



Adresa: Rruga e Durrësit, Nr. 219, Tiranë; Tel: +355(0)2243423/2266203;
web: www.ascal.al; e-mail: info@ascal.al